

VENDIM
Nr. 43, datë 25.1.2017

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË PUNËVE TË
BRENDSHME, PËR DREJTORINË VENDORE TË POLICISË VLORE, TË PRONËS
ME VENDNDODHJE NË FSHATIN SHKALLË, KONISPOL, ME NUMËR PASURIE
264, DHE ZONË KADASTRALE 3382, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 250, DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve të Brendshme, për Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, të pronës me vendndodhje në fshatin Shkallë, Konispol, me numër pasurie 264, dhe zonë kadastrale 3382, me sipërfaqe trualli 2 312 (dy mijë e treqind e dymbëdhjetë) m² dhe sipërfaqe ndërtimore 534 (pesëqind e tridhjetë e katër) m², sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim sistemimin e efektivave të Stacionit të Policisë Konispol.

2. Ministrisë së Punëve të Brendshme i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhen vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, shtohet prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë së Shtetit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, si dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

distance from W
 240 - 200 = 40
 40 / 2 = 20



